

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Violeta Namani dhe Zyrtarja Ligjore Selvete Cakolli, në çështjen penale, kundër të pandehurit L. A. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188. Par 1 pika 1.4 të KPRK-se i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3990/2015 te datën 11.01.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor-dënim me gjobë, gjykata jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 21.08.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr 3990/2015 te datës 11.01.2017, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit – L. A. i biri i A. dhe Gj., e gjinis Z., i lindur me *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin D., Komuna P., i martuar ID *numri personal...* shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës.

SEPSE

Me datën 24.05.2015 rreth orës 03:00h, në P. në hyrje të lokalit “M. P.”, ku i pandehuri ka qenë puntorë i sigurimit, kur i dëmtauri F. SH., ka deshtë të hynë në loakl si musafir, i pandehuri nuk e ka lejuar edhe përkundër që i dëmtauri e ka lutur, pastaj me qëllim që ta largoj e ka goditur me duar në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore,-.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188. par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 € (dyqind e pesëdhjetë Euro)**, të cilin dënim, i akuzuari L. A. obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre (3) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi- urdhri ndëshkimor.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Obligohet e pandehura të paguaj shpenzimet e procedurës, aq sa do te behete sipas llogarisë përfundimtare te kësaj gjykate, ekspertin mjeko ligjor ne shumen prej 20.00 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **njëzet (20) €**.

I dëmtuari – dëshmitari F. SH. me vendbanim në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. 3990/15 të datës 11.01.2017, e ka akuzuar L. A. për shkak të veprës Lëndim i lehtë trupor nga neni 188. Par 1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë-dënim me gjobë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-s, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura aktakuzës në shkresat e lëndës, dhe atë : mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko –ligjore i dt. 18.09.2016 dhe shkresat e lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri, ka kryer veprën penale për të cilën për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor si në dispozitiv të këtij Aktgjykim-Urdhri Ndëshkimor.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450, të KPPK.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 KPPK-së pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.27/2017, datë. 21.08.2017.

**Zyrtarja Ligjore,
Selvete Cakolli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Violeta Namani**

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim dhe me gojë.